



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION










# PERIODIKU BANKAR

PUBLIKIM I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

**VOLUMI 4 / NUMRI 1**

# PERIODIKU BANKAR

MBËSHTETUR NGA:

 <p>Banka Ekonomike</p>	 <p>BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE</p>	 <p>BPB</p>	 <p>İŞBANK</p>	 <p>NLB Banka</p>
 <p>ProCredit Bank</p>	 <p>Raiffeisen BANK</p>	 <p>TEB BNP PARIBAS JOINT VENTURE</p>	 <p>ZiraatBank</p>	

# PËRMBAJTJA

**04**

Hyrje

---

**07**

Kreditë për ekonomitë familjare dhe për ndërmarrjet;

---

**10**

Shoqata e Bankave të Kosovës dhe BERZH organizuan një tryezë pune rreth Faktoringut

---

**13**

Rreth SHBK-së

---

**05**

Kreditë bruto në raport me depozitat

---

**08**

Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës zhvilluan takimin e parë për vitin 2017

---

**11**

Normat efektive të interesit [Kreditë dhe Depozitat]

---

**06**

Java Ndërkombëtare e Parasë 2017

---

**09**

Kreditë jo-përformuese

---

**12**

Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC organizuan tryezë të rrumbullakët rreth çasjes në financa për Agro-bizneset

---

## Periodiku bankar

Periodiku bankar është një edicion i ri i publikimeve të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) i cili botohet dy herë brenda vitit (gjatë muajit prill/maj dhe shtator/tetor) dhe që paraqet volumnin e katërt të publikimeve të rregullta. Ky publikim ka për qëllim që të informoj lexuesit e saj mbi treguesit kryesorë të zhvillimit të industrisë bankare, përkatësisht të ofroj informatat më të rëndësishme të cilat mund të ju interesojnë çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

Lexuesit e Periodikut Bankar, gjithashtu, mund të gjejnë informata mbi aktivitetet kryesore që Shoqata e Bankave të Kosovës.

Përveç kësaj, Periodiku bankar ofron një pasyqërë mbi zhvillimet më pozitive të treguesve kryesorë të sektorit bankar si dhe të aktiviteteve që i realizon në dobi të industrisë bankare, ekonomisë së Kosovës, mirëpo edhe në dobi të mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë tonë.

Ky periodik bankar është realizuar me përkrahjen e bankave komerciale në Kosovë, përkatësisht anëtarëve të saj.


## KREDITË BRUTO NË RAPORT ME DEPOZITAT (2010 -2016)

Milion euro

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,702.9	2,897.9
Kreditë bruto dhe lizingjet	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.3	2,019.5	2,230.0
Raporti	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	74.7%	77.0%

Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## DEPOZITAT NË RAPORT ME KREDITË (2010-2016)



■ Depozitat    ■ Kreditë bruto dhe lizingjet

Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

05

Në vitin 2016,

# 77%

e gjithsej depozitave i janë kthyer ekonomisë në formë të kredidhënies nga industria bankare

Brenda pesë viteve të fundit, depozitat u rritën për

# 37%

Brenda pesë viteve të fundit, kreditë u rritën për

# 31%

# Java Ndërkombëtare e Parasë në Kosovë 2017

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) nga data 27 mars deri më datën 2 prill 2017 organizoi aktivitete edukativo-arsimore për të fuqizuar edukimin financiar në kuadër të Javes Ndërkombëtare të Parasë 2017. SHBK organizoi orë mësimore dhe aktivitete të ndryshme për fëmijët e shkollave fillore në këto komuna të Kosovës: Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë, Podujevë dhe Gjilan. Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Muzeun e Kosovës hapen zyrtarisht Javen e Parasë me moton "Mëso.Kurse. Fito.". Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijë të shkollave fillore, fëmijë me sindromin Down si dhe fëmijë të komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

Java Ndërkombëtare e Parasë është një javë që shënohet në mbi 132 vende të botës dhe ka për qëllim avancimin e edukimit financiar për fëmijë dhe të rinjë. Kjo iniciativë organizohet nën koordinimin e organizatës ndërkombëtare financiare për të rinjë dhe fëmijë Child and Youth Finance International, ndërsa Shoqata e Bankave të Kosovës organizon këtë ngjarje në Kosovë si anëtare e kësaj organizate që nga viti 2013.



Në vitin 2016, bankat në Kosovë kanë lëshuar kredi të reja për biznese në vlerën prej

**577.9€** mln

Në vitin 2016, bankat në Kosovë kanë lëshuar kredi të reja për ekonomitë familjare në vlerën prej

**447.2€** mln

Në vitin 2016, bankat në Kosovë kanë lëshuar gjithsej kredi të reja në vlerën prej


**1,025.1€** mln

## KREDITË PËR EKONOMITË FAMILJARE DHE PËR NDËRMARRJET

Milion euro

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
Kreditë për ekonomitë familjare	542.6	563.9	635.3	694.3	796.6
Kreditë për ndërmarrje	1,194.2	1,217.4	1,256.4	1,333.4	1,410.1

Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese, dhe Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese, dhe Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik



## Shoqata e Bankave të Kosovës dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbajtën takim in gjashtëmuor për pjesën e parë të vitit 2017

Shoqata e Bankave të Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës organizuan takim in e përbashkët të gjashtëmuorit të parë për vitin 2017.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të prezantohen të arriturat e sektorit bankar për vitin 2016 dhe sfidat për vitin 2017, si dhe aktivitetet mbikëqyrëse të BQK-së për vitin 2016 dhe objektivat për vitin 2017.



Bankat në Kosovë kanë arritur të menaxhojnë një portfolio të shëndoshë kreditore, duke shënuar nivelin më të ultë të kredive jo-performuese në fund të vitit 2016 prej

# 4.9%

të gjithsej portfolios kreditore


Sektori bankar ka pas një zgjerim shumë dinamik të kreditimit gjatë 2016, duke arritur një normë të rritjes prej

# 10.4%

## KREDITË JO-PËRFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Kreditë jo-përformuese (%)	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%	4.9%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.7%	12.5%	36.6%	18.8%	-1.7%	-18.9%	-12.7%
Përqindja e rritjes kreditore	13.2%	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%	7.3%	10.4%

Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore



Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

## Shoqata e Bankave të Kosovës dhe BERZH organizuan një tryezë pune rreth Faktoringut



Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) më 9 shkurt 2017 organizuan një tryezë pune rreth Faktoringut. Qëllimi i organizimit të kësaj punëtorie ishte që të diskutohet mbi nivelin aktual të zhvillimit të faktoringut në Kosovë por edhe në vendet e tjera me synim që të bashkërendohen veprimet në rritjen e qasjes në financa për NVM-të. Në këtë tryezë pune morën pjesë përfaqësues të bankave komerciale në Kosovë si dhe të kompanive të tjera në këtë fushë.

Në fjalën hapëse të kësaj tryeze pune drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, z. Petrit Balija, tha që kjo tryezë rreth Faktoringut është e rëndësishme për sektorin bankar. Pasi ai paraqiti në pika të shkurta gjendjen e sektorit bankar, ai përmendi edhe sfidat me të cilat përballon sektori dhe të cilat e bëjnë më të vështirë që shërbimet financiar siç është Faktoringu të ofrohen në treg me kushte të volitshme.

Mungesa e zbatimit të kontratave, mungesa e sigurimit të rendimentit bujqësor, paisjeve dhe objekteve, numri i vogël i përmbauesve privat dhe mungesa e efikasitetit, informaliteti i lartë dhe pasqyrat e pa audituara janë disa nga barrierat dhe sfidat e sektorit bankar.

Tryeza rreth Faktoringut vazhdoi me prezantimet nga panelistët, z. Erik Timmermans nga Factors Chain International (FCI) i cili bëri një përmbledhje çka është faktoringu dhe prezantoi të dhënat të rëndësishme rreth faktoringut. Ndërsa ana ligjore dhe korniza rregullative e Faktoringut u prezantua nga z. Ammar Al-Saleh nga BERZH. Ndërsa në fund u hap diskutimi mes panelistëve dhe pjesëmarrësve ku diskutuan rreth barrierave dhe zhvillimit të Faktoringut në Kosovë.

Për herë të parë në vitin 2014 është shënuar vlerë NJËSHIFRORE e normës së interesit për kredi

Brenda pesë viteve, norma efektive e interesit për kredi ka pasur një rënie prej

# 45.7%


Diferenca ndërmjet normës efektive të interesit për kredi dhe normës për depozita ka shënuar ulje të vazhdueshme, duke arritur nivelin më të ultë në vitin 2016 në vetëm

# 5.9%.

## NORMA EFEKTIVE E INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.22%
Norma efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	1.24%
<b>Diferenca</b>	<b>10.59%</b>	<b>9.68%</b>	<b>8.52%</b>	<b>8.50%</b>	<b>8.18%</b>	<b>6.54%</b>	<b>5.98%</b>

Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi dhe depozita për sektorin bankar



Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi dhe depozita për sektorin bankar



## Shoqata e Bankave të Kosovës dhe IFC organizuan tryezë të rrumbullakët rreth çasjes në financa për Agro-bizneset

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) në bashkëpunim me International Finance Corporation (IFC) pjesë e grupit të Bankes Botërore më 10 shkurt 2017, organizuan tryezën e rrumbullakët me përfaqësuesit e bankave komerciale në Kosovë. Në këtë tryezë u paraqit projekti i IFC-së në Kosovë rreth Agro-Financimit. Ky projekt ka për qëllim të zhvilloj dhe avancoj huadhënien për agrokulturë në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti do të zhvillohen metoda për huadhënie dhe trajnime për çasje më të madhe në financa për këtë sektor.

Në fjalën hapëse të kësaj tryeze drejtori ekzekutiv i Shoqates së Bankave të Kosoves, z. Petrit Balija, mirëpriti organizimin e kësaj tryeze me IFC si dhe i njoftoi të pranishmit rreth performancës së sektorit bankar në aspektin e agro-financimit. Balija tha që së bashku me rritjen e performancës së sektorit bankar, kreditimi i agro-bizneseve dhe sektorit të prodhimit për herë të parë është rritur më shumë se në të kaluarën. Balija përmendi disa nga arsyet pse ky sektor ka një pjesëmarrje më të vogël në portfolion kreditorë. Mungesa e sigurimit të kulturës bujqësore (rendimentit) ndaj kushteve të paparashikuara klimatike, ndaj sëmundjeve të ndryshme të bimëve, regjistrimi jo i rregullt i mjeteve dhe pronës për t'u kualifikuar për kolateral, mungesa e biznes planit fizibil, informaliteti i lartë dhe pasqyrat e paudituar financiare janë vetem disa nga arsyet e përmendura.

Ndërsa Menaxherja Regjionale e këtij projekti, znj. Leah Soroka, prezantoi në detaje qëllimin dhe objektivat e këtij projekti. Ndër të tjera ajo tha që ky projekt do të fokusohet në zhvillimin e metodës CLARA për kuptimin më të mirë të kostos së prodhimit dhe vlerësimin e rrjedhës së parasë së gatshme në ndërmarrjet bujqësore. Objektivi tjetër i këtij projekti do të jetë dhënia e trajnimeve për fermerët në mënyrë që të kuptojnë më mirë instrumentet financiare. Ky takim paraqet vetëm fillimin e takimeve dhe diskutimeve që do të zhvillohen me sektorin bankar, në mënyrë që të përmirësohet kreditimi i agro-bizneseve dhe menaxhimi i ndërmarrjeve bujqësore (agro-ndërmarrjeve).

## **Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) - Zëri i industrisë bankare në Kosovë**



Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) përfaqëson sektorin bankar në Kosovë duke bashkëpunuar me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, mediat dhe publikun. Qëllimi i SHBK-së është të mbështesë një sistem të shëndoshë bankar dhe konkurrencë të drejtë dhe të hapur, si dhe edukimin financiar për klientët bankarë, dhe në këtë mënyrë të nxisë zhvillimin ekonomik afatgjatë në Kosovë.

SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave duke ofruar një platformë të vetme për të diskutuar iniciativat e reja. SHBK gjithashtu identifikon dhe rishikon nismat ligjore dhe rregullative, koordinon aktivitetet e përbashkëta për sektorin bankar, dhe promovon aktivitetet bankare tek audienca e gjerë

E themeluar në vitin 2002, SHBK-ja është një pikë kryesore referimi në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me sektorin bankar në Kosovë. Aktualisht, SHBK përfaqëson nëntë banka komerciale: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka për Biznes (BpB), IsBank, NLB Banka, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB Bank dhe Ziraat Bank.



**Qendra për Trajnime  
Bankare**

Qendra për Trajnime Bankare në SHBK ofron programe certifikimi për stafin e sektorit financiar.



**SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS**  
**KOSOVO BANKING ASSOCIATION**



+381 38 246 171  
+381 38 246 172



Rr. Lidhja e Pejës, Zona Industriale, 10 000,  
Prishtinë - Fushë Kosovë,  
Kosovë



[contact@bankassoc-kos.com](mailto:contact@bankassoc-kos.com)  
[bankassoc-kos.com](http://bankassoc-kos.com)



Shoqata e Bankave të Kosoves



Kosovo Banking Association